



CIMC – 2007/05

Në pajtim me Nenin 16 të ligjit Nr. 02/L-15 mbi Komisionin e Pavarur për Media dhe Transmetim dhe nenit 10 të rregullores për distribuimin kabllor të programeve radio televizive në Kosovë, Këshilli i Komisionit të Pavarur për Media mori

Vendim

për nivelin, mënyrën e përcaktimit të pagesës të taksës për Licencim të Operatorëve Kabllorë dhe Ofruesve të shërbimeve të programeve përmes kabllor

Neni 1

Përmbajtja e Vendimit

1.1 Ky vendim do të rregullojë:

- a) Nivelin e taksës së licencës për operatorët kabllorë
- b) Nivelin e taksës së vetme për aktivitetet në lidhje me regjistrimin e aplikuesit për lëshim, ndryshim apo vazhdim të licencës për operatorët kabllorë
- c) Nivelin e taksës së licencës për ofruesit e shërbimevet të programit përmes kabllor
- d) Nivelin e taksës së vetme për aktivitetet në lidhje me regjistrimin e aplikuesit për lëshim, ndryshim apo vazhdim të licencës për ofruesit e shërbimevet të programit përmes kabllor

Neni 2

Niveli i taksës së vetme për procesimin e regjistrimit

- 2.1 Taksa paushalle prej 100 Euro do të paguhet për secilin aplikacion për regjistrim, lëshim, ndryshim apo vazhdim të licencës.

- 2.2 Kjo taksë do t'i paguhet Komisionit të Pavarur për Media me rastin e paraqitjes së aplikacionit, pa mundësi të kthimit të taksës.

Neni 3

Niveli i taksës vjetore për licencim të Operatorëve Kabllorë

- 3.1 Secili operator kabllor do të paguajë taksën vjetore për secilën komunë sipas skemës së mëposhtme:

A- komuna e Prishtinës 7,258.06 EURO

B-komuna e Prizrenit 3,120.97 EURO

C-komunat e Ferizaj/Urosevac, Prizren/Prizren, Peja/Pec, Mitrovica/Mitrovica, Gjilan/Gnjilane, Gjakove/Djakovica, Podujeva/Podujevo 1,596.78 EURO

D- komunat e përcaktuara në 3.1 A, B dhe C pa përfshirë zonën qendrore kadastrale të komunave respektive 423.39 EURO

E-të gjitha komunat tjera 423.39 EURO

- 3.2 Operatorë Kabllorë, paketa programore e të cilëve përbëhet prej më shumë se 20 % të kanaleve të cilat transmetojnë në gjuhët në përdorim në Kosovë, me përjashtim të gjuhës angleze, e që nuk janë gjuhë e shumicës në komunën të cilën e mbulon operatori kabllor, do të paguajnë taksë vjetore prej 50% të vlerave të përcaktuara në nenin 3.1.

Neni 4

Regjistrimi i Ofruesve të shërbimeve të programeve përmes kabllor

- 4.1 Në pajtim me nenin 16 të Rregullores për Distribimin Kabllor të Programeve Radio Televizive në Kosovë të gjithë ofruesit e shërbimeve të programeve përmes kabllor do të rregullohen si subjekte transmetuese.

- 4.2 Operatorët Kabllorë do të bartin vetëm programet e subjekteve të licencuara të transmetimit nga autoritet e tyre rregullative të transmetimit.
- 4.3 Ofruesit e shërbimeve të programeve përmes kabllos të cilët përndryshe nuk janë të licencuar si subjekte transmetuese mund të aplikojnë në KPM për licencë për ofrues të shërbimit të programeve përmes kabllos në pajtim me nenin 16.4 të Rregullores për Distribimin Kabllor të Programeve Radio Televizive në Kosovë.
- 4.4 Zyra e KPM do t'u ofrojë aplikuesve format e aplikacionit të cilat do të kërkojnë nga aplikuesi të demonstrojnë lidhje me Kosovën dhe të ofrojnë informata relevante në lidhje me:
- a) formatin dhe skemën programore të propozuar , duke marrë parasysh kërkesën për atë shërbim;
 - b) sasinë e programit lokal të prodhuar; prezentimin e një plani të qartë dhe praktik për organizimin dhe mirëmbajtjen e ofruesit të shërbimit të programeve përmes kabllos; dhe
 - c) pajtueshmëri të plotë me rregullën e përgjithshme të aplikueshme mbi kualifikimet për licencë.

Neni 5

Niveli i taksës së licencës për ofruesit e shërbimit të programeve përmes kabllos

- 5.1 Taksa paushalle prej 100 Euro do të paguhet për secilin aplikacion për regjistrim, lëshim, ndryshim apo vazhdim të licencës të ofruesit të shërbimit të programeve përmes kabllos.
- 5.2 Taksa vjetore për ofruesit e shërbimit të programeve përmes kabllos do të jetë për stacion 1,260 Euro për radio dhe 3,780 Euro për television. Licenca do të jetë valide për transmetim përmes kabllos kudo brenda territorit të Kosovës.
- 5.3 Zbritjet e mëposhtme në përqindje të taksës së licencës për ofruesit e shërbimit të programeve përmes kabllos të cilët transmetojnë programe specifike në gjuhë të

minoriteteve dhe/ose programe eksplicite të shërbimit publik (për shembull lajmet, programet informative, kulturore, edukative) vlejnë:

- a) 20% për ofruesi i shërbimit të programeve përmes kabllos gjuha primare e të cilave është gjuhë në përdorim në Kosovë, përvës gjuhës Shqipe;
- b) 5% për së paku 20 për qind / 10% për së paku 30 për qind të programit lokal dhe/ose programit të vetë prodhuar me karakter të shërbimit publik (lajme, programe informative, kulturore, edukative, duke përfshirë muzikën)

5.4 Të gjitha përqindjet që zbriten nga taksa e licencës për të cilat ofruesi i shërbimit të programeve përmes kabllos kualifikohet do të mblidhen.

Neni 6

Mënyra e pagesës së taksës


- 6.1 Taksa Vjetore për licencë do të depozitohet në tërësi në një xhirollogari të caktuar të KPM-së.
- 6.2 Taksa e parë vjetore do të paguhet jo më vonë se 14 ditë pas pranimi të Licencës.
- 6.3 Për vitet pasuese taksa do të paguhet jo më vonë se 30 ditë pas fillimit të vitit kalendarik.
- 6.4 Nëse bartësi i licencës ndërpret shërbimin para skadimit të kohës për të cilën kohë taksa është paguar pjesa e mbetur e taksës nuk do të kthehet.
- 6.5 Nëse është verifikuar se i licencuari ka zgjeruar zonën e mbulimit jashtë zonës së caktuar në licencën e tij, KPM retroaktivisht mund të caktojë të licencuarit dyfishin e vlerës së taksës që ai do të paguante për zonën e tij të palicencuar, nëse ai mbulim i zonës do të përcaktohej në licencën e tij. Kjo pagesë është si shtesë e çdo sanksioni që KPM mund të vendosë.
- 6.6 Në rast të pagesës së taksës vjetore me vonesë, i licencuari do të paguajë kamatë për vonesë të pagimit të taksës.

- 6.7 Niveli i kamatës do të caktohet sipas nivelit të kamatës që e aplikon Administrata tatimore e Kosovës për vonesa në pagimin e tatimit.
- 6.7 Mospagimi i taksës së licencës do të rezultojë në sanksionimin e operatorit kabllor dhe ofruesit të shërbimit të programit përmes kabllor, në pajtim me Ligjin dhe Rregulloret e KPM-së.

Neni 7

Hyrja në fuqi

Ky vendim hyn në fuqi në datën e nënshkrimit.



Isuf Berisha



06.07.107

Datë

Kryetar i Këshillit të KPM-së